

BARKODI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL “SHËRBIME MEKATRONIKE NË AUTOMJETE”

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Pajisja për zbutjen e impulseve të fuqisë nga motori quhet: **1 pikë**
- A) Volant;
 - B) Bosht me gunga;
 - C) Kollodok ;
 - D) Friksion;
2. Në motorin me naftë, raporti i kompresimit është: **1 pikë**
- A) 5:1;
 - B) 10:1;
 - C) 15:1;
 - D) 20:1;
3. Në motorin e automjetit preferohen pistonët e aliazhit të aluminit sepse: **1 pikë**
- A) Janë amortizues të mirë të goditjeve;
 - B) Kanë më pak peshë;
 - C) Kanë rezistencë të mirë ndaj ujit;
 - D) Janë shumë të fortë në tension;
4. Sulfatimi i pllakave të baterive lehtësohet nga: **1 pikë**
- A) Shkarkim i menjëhershëm i baterisë;
 - B) Temperatura shumë e lartë e baterisë;
 - C) Densitet i lartë i elektrolitit;
 - D) Densitet i ulët i elektrolitit;
5. Frenimi rigjenerues është një teknikë që përdoret në automjetet elektrike dhe ato hibride: **1 pikë**
- A) Për të recuperuar energjinë që do të shkonte dëm gjatë frenimit;
 - B) Për të ngadalësuar mjetin;
 - C) Për të pershpejtuar mjetin;
 - D) Për të ulur efikasitetin e frenimit;
6. Nga komponentët tek automjetet elektrike, vetëm paketa e baterisë dhe motori kontribuojnë në rreth: **1 pikë**
- A) 50% të peshës totale të makinës;
 - B) 70% të peshës totale të makinës;
 - C) 30% të peshës totale të makinës;
 - D) 10% të peshës totale të makinës;
7. Qëllimi i Komandimit elektronik të sistemit të varjes së automjetit është: **1 pikë**
- A) Të rrisë sigurinë dhe komoditetin e drejtimit ;
 - B) Të rrisë sigurinë , jo komoditetin e drejtimit;
 - C) Të rrisë vetëm komoditetin e drejtimit ;
 - D) Të rrisë vetëm sigurinë ;
8. Kandelat e nxehta janë projektuar për motorët: **1 pikë**
- A) E shpejtë, me sistem ndezës me tiristor;
 - B) E ngadaltë, me raport të ulët të ngjeshjes;
 - C) Me dy kohë, me raport të lartë të ngjeshjes;
 - D) Me ftohje me ajër;

9. Në një motor me benzinë, me katër cilindra, si rregull, vendosja e fazës së ndezjes i referohet: **1 pikë**
- A) Pistonit të parë;
 - B) Pistonit të dytë;
 - C) Pistonit të tretë;
 - D) Pistonit të katërt;
10. Qëllimi i i sensorit të rrjedhës së masës së ajrit (MAF) është të: **1 pikë**
- A) Përcaktojë shpejtësinë e automjetit nga presioni i ajrit që vepron në sensor;
 - B) Kontrollon sasinë e oksigjenit në gazrat e shkarkimit;
 - C) Informon kompjuterin për sasinë e ajrit që hyn në cilindrata e motorit;
 - D) Monitoron shkallën e ndotjes së filtrit të ajrit;
11. Ndryshimi midis llambave ksenon dhe llambave halogjene është: **1 pikë**
- A) Në metodën e montimit në fener;
 - B) Në shkëlqimin e dritës së dhënë;
 - C) Në përdorimin për dritat e shkurtra ;
 - D) Në spiralen inkandeshente;
12. Sistemi i ftohjes me lëng i motorit është: **1 pikë**
- A) I hapur;
 - B) I mbyllur;
 - C) Me vetërrjedhje;
 - D) Me spërkatje;
13. Çepat e frenave janë të lakuar për t'u përshtatur me diametrin e brendshëm të: **1 pikë**
- A) Gomës;
 - B) Rrotës;
 - C) Pedalës;
 - D) Tamburit të frenave;
14. Cili nga elementët e mëposhtëm **nuk** është i pranishëm në hidroxhuntë? **1 pikë**
- A) Rrota e turbinës;
 - B) Rrota e pompës;
 - C) Rrota e reaktorit;
 - D) Rrota transformuese;
15. Përdorimi i një friksioni me shumë disqe mundëson: **1 pikë**
- A) Shpërndarjen në mënyrë proporcionale të momentit rrotullues midis rrotave aktive;
 - B) Zvogëlimin e përmasave të friksionit;
 - C) Lehtësimin e mirëmbajtjes dhe riparimit të friksionit;
 - D) Rritjen e fuqisë së motorit;

16. Vëllimi i punës së cilindrit është vëllimi: **1 pikë**
- A) Ndërmjet PSV dhe kokës së motorit;
 B) Mbi piston kur ndodhet në PPV;
 C) I dhomës së djegies;
 D) I cilindrit ndërmjet PSV dhe PPV;
17. Amortizatorët e automjetit: **1 pikë**
- A) Nuk ndikojnë në stabilitetin e mjetit gjatë udhëtimit;
 B) Zvogëlojnë ngarkesat goditëse që merr rrota nga rruga;
 C) Kthejnë goditjet në lëkundje;
 D) Pengojnë rrëshqitjen gjatë frenimit;
18. Shkronja "V" në markimin 205/55R16V e një gome tregon: **1 pikë**
- A) Indeks të gjerësisë;
 B) Indeks të shpejtësisë;
 C) Indeks të diametrit;
 D) Indeks të ngarkesës;
19. Sensoret aktive të shpejtësisë së rrotave në sistemin e frenimit kundër bllokimit (ABS): **1 pikë**
- A) Përdorin burim të jashtëm të energjisë elektrike;
 B) Nuk ofrojnë saktësi të lartë matjeje;
 C) Instalohen drejtëpërdrejt në gomën e rrotës;
 D) Kane sinjal në dalje që varet nga shpejtësia e rrotës;
20. Cila veçori është disavantazh i motorit me naftë, krahasuar me atë me benzinë: **1 pikë**
- A) Rendimenti më i ulët;
 B) Nevoja për një sistem ndezës;
 C) Konsum më të madh të lëndës djegëse;
 D) Fuqi të ulët të motorit;
21. Listoni katër komponentë thelbësorë të CPU-së: **4 pikë**
1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
22. Në secilin nga pohimet e mëposhtme për sistemin e frenimit, vendosni e vërtetë (V) ose e gabuar (G): **4 pikë**
- 1) Forca e frenimit midis rrotave dhe rrugës nuk është e drejtuar në të njëjtin kah me lëvizjen e mjetit. ____
- 2) Procesi i frenimit të një automjeti është krijimi i një force (ose forcash) që pengon rrotullimin e rrotave. ____
- 3) Gjatë procesit të frenimit nxehtësia shndërrohet në energji mekanike. ____
- 4) Gjatë frenimit, energjia kinetike e lëvizjes së automjetit shndërrohet në punën e forcave të fërkimit. ____

23. Në seclin nga pohimet e mëposhtme, rretho përgjigjen e saktë.

4 pikë

a) Një automjet që mundësohet të lëvizë nga energjia elektrike quhet " automjet elektrik" .

PO JO

b) Automjetit elektrik mund t'i ngarkohet bateria direkt nga priza elektrike shtëpiake.

PO JO

c) Një automjet elektrik është një mjet që lëviz plotësisht ose pjesërisht nga motorë elektrikë, duke përdorur energjinë e ruajtur në bateritë e ringarkueshme.

PO JO

d) Frenimi rigjenerues përdoret zakonisht në automjetet elektrike dhe hibride për të rikuperuar energjinë gjatë frenimit.

PO JO

24. Listoni katër komponentë nga komandimi elektronik i sistemit të varjes së automjetit:

4 pikë

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

25. Në seclin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë.

4 pikë

a) Sonda Lambda njofton në mënyrë konstante centralinën për temperaturën e ajrit.

PO JO

b) Sistemi i riciklimit të gazit të shkarkimit (EGR) përdoret në motorët me djegie të brendshme për të rritur temperaturën e gazeve të ricikluara.

PO JO


c) Sistemet multiplekse (CAN- BUS) sigurojnë lidhjen e njësisive të kontrollit elektronik me njëra-tjetrën dhe transmetimin e sinjaleve të kontrollit në formë dixhitale.

PO JO

d) Motorino e lëshimit të motorit vihet në lëvizje duke thithur rrymë nga një burim me rrymë alternative.

PO JO

26. Në skemën e motorit me injeksion elektronik, për pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë: **4 pikë**



- | | | |
|---|----|----|
| 1) Elementi «11» është pjesë e Sistemit të Kontrollit të Emisioneve Avulluese (EVAP). | PO | JO |
| 2) Elementi «7» është valvulë elektronike flutur . | PO | JO |
| 3) Elementi «3» kryen pastrimin (gjenerimin) kur motori është i ftohtë. | PO | JO |
| 4) Elementi «9» përdoret për të llogaritur presionin në kolektorin e shkarkimit. | PO | JO |

27. Në figurën e mësipërme, emërtoni elementët: **4 pikë**


Elementi 2: _____

Elementi 6: _____

Elementi 8: _____

Elementi 10: _____

28. Në skemën e Komandimit elektronik të sistemit të drejtimit (EPS) të automjetit, emërtoni elementët. **4 pikë**




Elementi 2: _____

Elementi 3: _____

Elementi 4: _____

Elementi 5: _____

29. Në skemën e komandimit elektronik të AC/klimatizatorit, për pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë. **4 pikë**



1)Elementi «1» krijon presionin e duhur ,dukë shtypur lëngun ftohës në menyrë që ai të qarkullojë tek ftohësi.
 PO JO

2)Elementi «3»është vendosur në pjesën e përparme të radiatorit dhe shërben për të larguar nxehtësinë.
 PO JO

3) Elementi «6» ndryshon presionin e në sistemin e kondicionimit të ajrit ,nga presion i ulët në të lartë,të lëngut ftohës.
 PO JO

4)Elementi «7» shërben për thithjen e nxehtësisë nga brenda automjetit.
 PO JO

30. Listoni 4 detyrat e guarnicionit (hermetizuesit) të kokës së motorit:

4 pikë

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

